
**AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI I
SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË
KUFIZUAR
"Smile Dental Tirana" SHPK**

AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR "Smile Dental Tirana" SHPK

KREU I EMRI I SHOQERISE, SELIA, KOHEZGJATJA, OBJEKTI

NENI 1 EMRI I SHOQËRISË

1.1 Sot, ne Tirane më date 21/02/2019 ne të nënshkruarit :

Mikel Shabanllari, shtetas shqiptare, lindur në Erseke, më 10.10.1981, mbajtës i se kartës së identitetit me nr I11010129P,

themelojne këtë shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin

"Smile Dental Tirana" Shpk (Më poshtë e quajtur "Shoqëria")

NENI 2 SELIA

2.1 Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: Tirane, Kamez, Lagjja nr.2, Rruga Bulevardi Blu, Pallati Lala Konstruksion, Dyqani nr.2, seksioni nr.1, kati 2.

2.2 Ortaket mund të vendosin mbi transferimin e selisë së Shoqërisë në një adresë tjetër. Personat përgjegjës për administrimin e Shoqërisë mund të çelin ose mbyllin degë dhe/ose zyra përfaqësimi si brenda ashtu edhe jashte Republikës së Shqipërisë.

NENI 3 KOHËZGJATJA

3.1 Shoqëria do të zhvilloje aktivitetin e saj për një periudhe kohore me afat të pacaktuar duke filluar nga data e regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

NENI 4 OBJEKTI I SHOQËRISË

4.1 Shoqëria ka për objekt të saj kryerjen dhe marrjen pjesë në të gjitha aktivitetet që një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar mund të ushtrojë në bazë të legjislacionit shqiptar, dhe në veçanti:

Kabinet Dentar. Shoqëria gjithashtu mund të realizojë bashkëpunime me shoqëri të tjera që kanë të njëjtin objektiv ose të ngjashëm me atë të shoqërisë, si dhe në raste të vecanta në sektorë të

tjerë, bashkëpunime me persona fizikë, vetëm nëse këto veprime janë të quajtura të nevojshme ose të duhura për realizimin e objektivit të shoqërisë nga organi administrativ.

4.2 Për më tepër shoqëria mund të veproje si agjent/ndermjetes për kryerjen e aktiviteteve të mësipërme dhe bazuar në diskrecionin e saj të vetëm mund të kontraktoje palë të treta për kryerjen e një pjese apo të të gjitha shërbimeve të mesipërme.

4.3 Gjithashtu, Shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet tjetër të nevojshëm apo të dobishëm për realizimin e qëllimeve të saj përfshirë edhe aktivitetin e ofrimit të shërbimeve, tregtimin, importimin dhe eksportimin e mallrave.

4.4 Për të arritur objektin e saj, Shoqëria mund të realizojë drejtpërdrejtë apo në mënyrë të tërthortë çdo lloj pjesëmarrje në shoqëri të tjera shiptare apo të huaja, si edhe të hyje në marrëdhënie kontraktore, bashkëpunimi ose ortakërie me persona të tretë, privatë ose publike, vendas ose të huaj.

KREU II KAPITALI I SHOQËRISË TRANSFERIMI I KUOTAVE

NENI 5 KAPITALI I SHOQËRISË

5.1 Kapitali i Shoqërisë është 100,000 Lek, i përbërë nga 1 (një) kuote, e ndarë si më poshtë:

Mikel Shabanllari, person fizik, zotërues i 1 (një) kuote me 100% (njqindpërqind) dhe vlere 100,000 Lekë,

Derdhja e kapitalit do të kryhet pas regjistrimit të Shoqërisë në regjistrin tregtar, gjatë fazës së zhvillimit të aktivitetit të Shoqërisë.

NENI 6 TRANSFERIMI I KUOTAVE TË KAPITALIT TEK TË TRETËT

6.1 Transferimi i kuotave të kapitalit të Shoqërisë mund të bëhet me shitje, trashëgimi, ose me çdo mënyrë tjetër të parashikuar nga ligji.

6.2 Në rast transferimi të kuotave tek persona të treta jashtë Shoqërisë, qofte me shitje qofte me dhurim, ortakët që synon të transferojë kuotat duhet t'i komunikojë ortakëve të tjerë vullnetin e tij me shkrim. Ortakët e tjerë kanë të drejtën e parablerjes të kuotave të ortakëve, me kushte të barabarta, dhe duhet ta ushtrojnë këtë të drejtë brenda 30 ditëve nga marrja e komunikimit të vullnetit të ortakut për të transferuar kuotat.

6.3 Vlera e kuotes që transferohet do të përcaktohet nga një ekspert i emëruar nga ortakët me marrëveshje ose nga gjykata në rast se ortakët nuk bien dakort.



NENI 7
BARRA MBI KUOTAT E KAPITALIT

7.1 Kuotat e kapitalit të Shoqërisë mund të rëndohen lirisht me barrë siguroese apo të drejta të tjera reale

KREU III
ORTAKET E SHOQERISE, FINANCIMET

NENI 8
ORTAKËT

8.1 Ortaket e shoqërisë janë:

Mikel Shabanllari, shtetas shqiptare, lindur në Erseke, më 10.10.1981, mbajtës i kartës së identitetit me nr I11010129P,

NENI 9
ORGANET E SHOQERISE

9.1 Organet e Shoqerise janë:

- a) Asambleja e Pergjithshme;
- b) Administratoret.

Neni 10
ASAMBLEJA E PERGJITHSHME

10.1 Asambleja e Pergjithshme eshte organi me i larte vendimmarres i Shoqerise dhe merr vendime kur eshte mbledhur rregullisht.

10.2 Vendimet e marra nga Asambleja e Pergjithshme, e thirrur dhe e mbledhur rregullisht, ne perputhje me ligjin dhe me kete Statut jane te detyrueshme per te gjithë ortaket perfshire ata qe mungojne.

10.3 Asambleja e Pergjithshme mblidhet ne rastet e parashikuara nga ky Statut, nga ligji per shoqerite tregtare, ligje te tjera, dhe sa here eshte e nevojshme per mbrojtjen e interesave te Shoqerise.

10.4 Asambleja e Pergjithshme mbahet ne seline e Shoqerise ose ne çdo vend tjetër te shenuar ne njoftimin per mbledhje. Njoftimi per mbledhje i dergohet me shkrim te gjithë ortakeve jo me



vone se 7 (shtate) dite perpara dates se mbledhjes. Njoftimi duhet te permbaje vendin, daten, oren dhe rendin e dites se mbledhjes.

10.5 Mbledhja e Asamblese se Pergjithshme thirret nga administratoret. Thirrja e Asamblese se Pergjithshme mund te kerkohet edhe nga ortaku ose ortaket qe perfaqesojne te pakten 5% te totalit te votave ne Asamblene e Pergjithshme.

10.6 Asambleja e Pergjithshme thirret ne sesione te zakonshme e jashtezakonshme.

Neni 11

ASAMBLEJA E ZAKONSHME

11.1 Asambleja e zakonshme mblidhet, çdo vit brenda gjashte muajve nga data e mbylljes se vitit financiar, per miratimin e raportit te administratoreve, inventareve dhe llogarive vjetore.

11.2 Vendimet merren me shumice te zakonshme te votave ne prani te ortakeve me te drejte vote qe zoterojne me shume se 50 % te kuotave.

11.3 Nese nuk arrihet kuorumi sipas pikes 11.2, Asambleja do te mblidhet perseri jo me vone se 30 dite me te njejtin rend dite. Ne rast se as ne mbledhjen e dyte nuk arrihet kuorumi, ortaket e pranishem ose rregullisht te perfaqesuar do te perbejne kuorumin.

Neni 12

ASAMBLEJA E JASHTEZAKONSHME

12.1 Asambleja e Pergjithshme thirret ne sesione te jashtezakonshme sa here eshte e nevojshme per marrjen e vendimeve ne interes te Shoqerise.

12.2 Vendimet qe kane te bejne me (por pa u kufizuar vetem ne to): ndryshimin e neneve te Statutit, zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit, ndryshimin thelbesor te objektit te veprimtarise se Shoqerise, prishjen e Shoqerise konsiderohen vendime te jashtezakonshme.

12.3 Vendimet e jashtezakonshme merren nga Asambleja e Pergjithshme me $\frac{3}{4}$ e votave ne prani te ortakeve qe zoterojne me shume se gjysmen e numrit total te votave.

12.4 Nese nuk arrihet kuorumi sipas pikes 12.3, Asambleja mblidhet perseri jo me vone se 30 dite me te njejtin rend dite. Ne rast se ne mbledhjen e dyte nuk arrihet kuorumi, ortaket e pranishem ose rregullisht te perfaqesuar do te perbejne kuorumin.

Neni 13

Pjesemarrja, Votimi dhe Perfaqesimi

13.1 Secili ortak ka te drejten e pjesemarrjes dhe votimit ne mbledhjen e Asamblese se Pergjithshme. Votat e disponuara nga secili ortak jane ne numer te barabarte me kuotat e zoteruara prej tij.



13.2 Secili ortak mund te perfaqesohet ne mbledhjet e Asamblese nga nje ortak tjetër apo nga nje person i tretë me autorizim. Autorizimi mund te jepet vetem per nje mbledhje te Asamblese se Pergjithshme, e cila perfshin edhe mbledhjet vijuese me te njetin rend dite.

Neni 14

Kompetencat e Asamblese se Pergjithshme

14.1 Asambleja e Pergjithshme vendos per:

- a) percaktimin e politikave tregtare;
 - b) ndryshimin e Statutit;
 - c) emerimin dhe shkarkimin e anetareve te Keshillit te Administrimit dhe caktimin e shperblimit te tij/tyre;
 - d) emerimin dhe shkarkimin e likuidatori/eve dhe eksperteve kontabel te autorizuar dhe shperblimin e tyre;
 - e) mbikyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe raporteve te ecurise se veprimtarise;
 - f) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe raportet e ecurise se veprimtarise;
 - g) miratimin e zmadhimit dhe zvogelimit te kapitalit te Shoqerise;
 - h) pjestimimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
 - i) perfaqesimin e Shoqerise ne gjykate dhe ne procedime te tjera kunder administratorit/eve;
 - j) shperndarjen e fitimeve;
 - k) riorganizimin dhe prishjen e Shoqerise;
 - l) miratimin e rregullave proceduriale te mbledhjeve te Asamblese;
 - m) çeshtje tjetër te caktuar nga ligji ose nga ky Statut.
- n) Kërkesa për kredi bankare dhe / ose nënshkrimin të faturave, garanci ose garanci në favor të palëve të treta

NENI 15

FINANCIMI I SHOQËRISË

15.1 Organi i Administrimit te Shoqërisë në përputhje me dispozitat në fuqi përvec rasteve të zmadhimit te kapitalit ka të drejte të kërkoje nga ortakët e Shoqërisë fondet e nevojshme për arritjen e objektivave të shoqërisë

15.2 Financimet e mëtejshme të ortakeve në shoqeri do të jene me shperblim (interesa) apo pa shperblim, në varësi të titullit nëpërmjet të cilit do të levrohen këto fonde.



KREU IV ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

NENI 16 ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

16.1 Shoqëria administrohet nga nje Administratorë si mëposhtë;

Mikel Shabanllari, shtetas shqiptare, lindur në Erseke, me 10.10.1981, mbajtës i kartës së identitetit me nr I11010129P,

e cila emerohet nga ortakët e shoqerise për një periudhë 5 vjecare me të drejtë rizgjedhje.

Administratori shkarkohet nga detyra, ne çdo kohe, me vendim te zakonshem te Asamblese se Pergjithshme sipas Statutit te Shoqerise.

Administratori vepron me kompetenca të pakufizuara, kompetencat dhe detyrat e tije janë si mëposhtë:

- a) mbikeqyr dhe zbaton politiken e biznesit te Shoqerise;
- b) perfaqeson Shoqerine;
- c) kujdeset qe Shoqeria te zbatoje ligjet dhe standartet e mbajtjes se llogarive;
- d) pergatit dhe nenshkruan bilancin dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve ja paraqet Asamblese se Pergjithshme per miratim;
- e) siguron qe deklaratat e llogarive vjetore si dhe raporti i ecurise se biznesit dhe çdo deklarim tjetër i detyrueshem sipas ligjit ose statutit, jane bere siç duhet;
- f) siguron qe auditimi i librave dhe i te dhenave kryhet te pakten nje here ne vit nga eksperte kontabel te çertifikuar dhe raporti i llogaritave publike te çertifikuar t'i vihet ne dispozicion Asamblese se Pergjithshme;
- g) krijon nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rrethanat qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e Shoqerise;

16.2 Administratori mund te ndërmarrë apo të kërkoj kryerjen e të gjitha akteve që konsideron të nevojshme për arritjen e objektit të Shoqërisë pervec atyre që ligji apo statuti i rezervon Ortakeve apo organeve të tjera të Shoqërisë.

NENI 17
SHPËRBLIMI I ADMINISTRATORIT

17.1 Shpërblimi i administratorit të shoqërisë do të përcaktohet nga Ortaket e shoqërisë.

KREU V
KONTROLI KONTABËL I SHOQËRISË
VITI FINANCIAR DHE BILANCI

NENI 18
KONTROLI KONTABËL

18.1 Kontrolli i jashtëm kontabël i Shoqërisë kryhet nga Ekspert Kontabel të Autorizuar, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi. Ortaket do të emerojnë një apo më shumë ekspertë kontabël në ato raste kur emërimi i tyre konsiderohet i nevojshëm ose kërkohet në baze të ligjit.

NENI 19
VITI FINANCIAR

19.1 Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor të çdo viti.

NENI 20
BILANCI DHE REZERVAT

20.1 Me mbylljen e secilit vit financiar Administratores marrin masat e nevojshme për hartimin e bilancit të aktivitetit për vitin financiar të mbyllur në mënyrë që ortaket të vendosin mbi miratimin apo ndryshimet e mundshme të tij brenda afatëve të përcaktuara nga ligji.

20.2 Ortaket vendosin mbi ndarjen e dividendeve që rezultojnë si fitime sipas bilancit të miratuar rregullisht, pasi nga këto shuma janë zbritur humbjet e mundshme të viteve të mëparshme.

20.3 Ortaket në çdo moment mund të vendosin krijimin e rezervave, si edhe masën e tyre.

KREU VI
PRISHJA DHE NJOFTIMET

NENI 21
PRISHJA DHE LIKUIDIMI I SHOQËRISË

21.1 Në rastin e likuidimit të Shoqërisë do të zbatohen dispozitat e parashikuara në ligjin nr. 9901 datë 14/04/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare"



NENI 22 NJOFTIMET

22.1 Të gjitha njoftimet kërkesat ose komunikimet e tjera që u jepen personave ose që bëjnë personat sipas Statutit do të kryhen me shkrim ose përmes komunikimit elektronik (nese ka) dhe do të konsiderohen të kryera në mënyrë të rregullt kur u dërgohen në adresat e deklaruara prej tyre pranë Administratoreve të Shoqërisë.

22.2 Njoftimet zyrtare të komunikimeve me anë të mjeteve elektronike vërtetohen sipas Legjislacionit për nënshkrimin elektronik dhe dërgohen në adresat elektronike të deklaruara prej tyre.

22.3 Në rastin kur një kuote zotërohet nga më shumë se një person të gjitha njoftimet do ti drejtohen përfaqesuesit të bashkëzotëruesve të kuotës.

KREU VII DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

NENI 23 LIGJI I ZBATUESHËM

23.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë Akt themelimi dhe Statut dhe me ligjin shqiptar. Për sa nuk është parashikuar në këtë Akt, do të zbatohen dispozitat e legjislacionit shqiptar në fushën e shoqërive tregtare.

23.2 Ky Akt hartohet në 4 (kater) kopje origjinale në gjuhën Shqipe, dhe pasi lexohet nga Ortaku themelues, firmoset si me poshte prej tij.

MIKEL SHABANLLARI

